



VENDIM

Nr. 105 Datë 01.10.2013

**PËR
RINOVIMIN E LIÇENSËS SË SHOQËRISË “GEN – I TIRANA” SH.P.K
NR.74, ME SERI T08 PËR TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE,
LËSHUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË
ERE-S NR.130, DATË 02.12.2008**

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13 pika 1, nenit 45, pika 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 1, germa “g”; 12; 13; 14 pika 1 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plote /të pjesshem dhe rinovimit te licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 01.10.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “GEN – I Tirana” sh.p.k., për rinovimin e liçensës së furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Gen – I Tirana” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshem dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni specifik sipas tipit të liçensës (neni 9, pika 4/10, gërmat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Rinovimin e licenses të shoqërisë “Gen – I Tirana” sh.p.k, me Nr.74, Seria T08, për kryerjen e aktivitetit të Tregtimit të Energjisë Elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionereve nr.130, datë 02.12.2008, për një afat 5 (pesë) vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari në detyrë
Shkëlqim Bozgo**